



Në mbështetje të Nenit 12, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*), Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 28.12.2023, nxjerr:

V E N D I M

Për miratimin e ueb faqes, adresave elektronike zyrtare të arkivit dhe të komunikimit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

1. Miratohet ueb faqja e re zyrtare e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim Agjencia), adresat zyrtare të Agjencisë, arkivit si dhe komunikimit me jashtë.
2. Domeni zyrtari i ueb faqes së Agjencisë është: www.apk-rks.net;
3. Adresa zyrtare e Arkivit të Agjencisë është: Arkiva.APK@rks-gov.net;
4. Adresa zyrtare për komunikim nga jashtë është: info.apk@rks-gov.net.
5. Obligohen të gjithë nëpunësit në Agjenci, për zbatimin e këtij vendimi, duke përdorur adresat zyrtare të theksuara si në pikën 2 dhe 3 të dispozitivit të këtij Vendimi, varësisht mënyrës dhe formës së komunikimit, përmes mënyrës elektronike si dhe asaj fizike.
6. Vendimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ky vendim është nxjerrë konform ndryshimeve të reja ligjore Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nevojave që janë paraqitur me rastin e emërimit të ri të Agjencisë, logos së re, si rezultat i të cilave janë miratuar edhe format zyrtare të komunikimit të përcaktuara si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Sipas pikës 2 të këtij Vendimi ueb-faqja zyrtare sipas adresës www.apk-rks.net, duhet të vendoset në të gjitha shkresat zyrtare të Agjencisë për jashtë, përfshirë edhe në adresat zyrtare e-mail-at e nëpunësve të Agjencisë.

Adresa zyrtare e Arkivit të Agjencisë sipas pikës 3 të dispozitivit të këtij Vendimi Arkiva.APK@rks-gov.net, vlen për përcjelljen e të gjitha shkresave të Agjencisë përmes kësaj adrese, përjashtuar ato të cilat përcillen në formë fizike, të cilat menaxhohen nga Zyra e Arkivit të Agjencisë.

Adresa zyrtare për komunikim nga jashtë sipas pikës 4 të dispozitivit të këtij vendimi info.apk@rks-gov.net, vlen për qasjen e palëve nga jashtë për komunikim dhe adresim në Agjenci.

Andaj, nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Yll BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit



Vendimi i dërgohet:

- Të gjithë nëpunësve të Agjencisë;
- Zyrës së Drejtorit;
- Arkivit;